FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 92

Tiranë – E enjte, 30 prill 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 410, datë 17.4.2026	Për ndalimin e peshkimit në liqenin e Ohrit dhe grumbullimin e riprodhuesve të krapit.....	8355
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 437, datë 23.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....	8355
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 438, datë 23.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Letonisë.....	8357
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 439, datë 23.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE), të shfaqur në shtetin e Irlandës.....	8358
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 23, datë 4.3.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 2067, datë 6.10.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-4493, datë 13.11.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues.....	8361
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 14, datë 29.4.2026	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	8372

Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 15, datë 30.4.2026

Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit..... 8373

Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Elmaz Ramaliu..... 8374

URDHËR
Nr. 410, datë 17.4.2026

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENIN E OHRIT DHE GRUMBULLIMIN E RIPRODHUESVE TË KRAPIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, "Për peshkimin", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin të të gjitha llojeve të peshqve në liqenin e Ohrit (me përjashtim të koranit), konkretisht:

a) për gjuhcën (cironka) – *Alburnus Albidus Alborella,* prej 20 prillit deri më 20 korrik 2026;

b) për krapin – *Cyprynus Carpio,* prej 20 prillit deri më 20 korrik 2026.

2. Për periudhën 20.7.2026 deri më 20.8.2026, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 300 ml nga bregu.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në pikat e caktuara nga OMP Pogradec.

4. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA) të koordinojë veprimtarinë organizative, teknike dhe financiare me Qendrën e Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit, për gatishmërinë e marrjes së riprodhuesve të krapit *(Cyprynus Carpio).*

5. Për periudhën prej 20.4.2026 deri më 20.7.2026, të lejohet peshkimi i riprodhuesve të krapit, në përputhje me kapacitetet mbajtëse të Qendrës së Prodhimit të Rasateve të Koranit, në fshatin Lin të Pogradecit.

6. Veprimtaria e grumbullimit të riprodhuesve të organizohet dhe të kryhet nën drejtimin e DSHPA-së në bashkëpunim me OMP Pogradec, duke përcaktuar dhe aktivizuar për këtë qëllim, jo më shumë se 20 peshkatarë me përvojë, anëtarë të kësaj OMP-je.

7. Për zbatimin e këtij urdhri të hartohet një plan i përbashkët operativ veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në koordinim me OMP Pogradec.

8. OMP Pogradec të marrë të gjitha masat për zhvendosjen e objekteve, ku peshqit kanë lëshuar vezët në mënyrë natyrale, në rastet e rënies së nivelit të ujit në liqen.

9. OMP Pogradec bashkëpunon me strukturat vendore Pogradec, Komisariatin e Policisë, Policinë Tatimore, Drejtorinë Rajonale të AKU-së Korçë.

10. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Qendra e Prodhimit të Rasateve në fshatin Lin të Pogradecit, si dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit Pogradec.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 437, datë 23.4.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	**Ndarja administrative e nivelit të dytë**	**Ndarja administrative e nivelit të tretë**
Baden-Württemberg	Bodenseekreis	Überlingen*
Baden-Württemberg	Breisgau-Hochschwarzwald	Hexental*
Baden-Württemberg	Breisgau-Hochschwarzwald	Müllheim-Badenweiler*

Baden-Württemberg	Breisgau-Hochschwarzwald	St. Peter*
Baden-Württemberg	Enzkreis	Heckengäu*
Baden-Württemberg	Emmendingen	Elzach*
Baden-Württemberg	Karlsruhe	Pfinztal*
Baden-Württemberg	Ortenaukreis	Gengenbach*
Baden-Württemberg	Schwarzwald-Baar-Kreis	Raumschaft Triberg*
Baden-Württemberg	Waldshut	Waldshut-Tiengen*
Hessen	Bergstraße	Wald-Michelbach*
Rheinland-Pfalz	Eifelkreis Bitburg-Prüm	Südeifel*
Sachsen-Anhalt	Altmarkkreis Salzwedel	Kalbe (Milde)*
Saarland	Merzig-Wadern	Weiskirchen*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 278, datë 12.3.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 438, datë 23.4.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E LETONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55ºC në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55ºC në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55ºC në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57ºC në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65ºC në 39.8 sekonda;

ii. 70ºC në 3.6 sekonda;

iii. 74ºC në 0.5 sekonda;

iv. 80ºC në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Letonisë janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
1.	Dienvidkurzemes	Kalētu pagasts*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Letonisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 439, datë 23.4.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË ENCEFALOPATISË SPONGIFORME TË GJEDHIT (BSE), TË SHFAQUR NË SHTETIN E IRLANDËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ**:**

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit gjedh;

b) mishit të freskët dhe produkteve të mishit;

c) miellit proteinik me origjinë nga kafshët e llojit gjedh ose çdo produkt që përmban një material të tillë, që kanë origjinë nga një vend, zonë apo ndarje (kompartment) që paraqet rrezik të kontrolluar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) ose rrezik të papërcaktuar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE);

ç) gjakut dhe produkteve të gjakut të marra nga kafshët e llojit gjedh;

d) dhjamit të shkrirë dhe derivatet e dhjamit;

dh) dikalciumit fosfatit;

e) ileumit distal nga gjedhët e çdo moshe, si dhe kafka, truri, sytë, shtylla kurrizore dhe palca kurrizore nga gjedhët që në momentin e therjes kanë qenë mbi 30 muajsh ose çdo produkt i kontaminuar prej tyre, që kanë origjinë nga një vend, zonë apo ndarje (kompartment) që paraqet rrezik të papërcaktuar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE), rrezik të kontrolluar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE), nëse këto produkte rrjedhin nga gjedhë të lindur përpara datës nga e cila është provuar se rreziku i riciklimit të agjentit të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) në popullatën e gjedhit është bërë i papërfillshëm;

ë) ushqimit, ushqimit për kafshë, plehra, produkte kozmetike, farmaceutike (përfshirë biologjike), pajisjet mjekësore ose çdo produkt tjetër që përmban proteina të përgatitura, duke përdorur

materialet e përmendura në shkronjën "e" të kësaj pike.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE), të shfaqur në shtetin e Irlandës janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1
1	Kilkenny*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të shtetit të Irlandës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit gjedh:

i. të përzgjedhur për eksport janë identifikuar përmes një sistemi identifikimi të kafshëve që mundëson gjurmimin e tyre gjatë të gjithë jetës së tyre; dhe/ose

ii. të përzgjedhur për eksport kanë lindur dhe janë mbajtur në një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm ose të kontrolluar të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) pas datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhëve është treguar i papërfillshëm; ose

iii. të përzgjedhur për eksport, janë provuar se nuk janë ushqyer kurrë me miell proteinik të nxjerrë nga kafshët ripërtypëse;

b) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton, që:

i. kafshët e llojit gjedh nga i cili është nxjerrë mishi dhe produktet e mishit të freskët të jenë identifikuar përmes një sistemi identifikimi të kafshëve;

ii. kafshët e llojit gjedh i janë nënshtruar një inspektimi *ante mortem* me rezultate të favorshme;

iii. kafshët e llojit gjedh kanë lindur dhe janë mbajtur, në:

- një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE); ose

- një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të kontrolluar të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) pas datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhit është treguar i papërfillshëm; ose

- një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të kontrolluar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) para datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhit është treguar i papërfillshëm, dhe mishit dhe produkteve të mishit të freskët janë nxjerrë nga gjedhë që nuk i janë nënshtruar një procesi trullosjeje me një pajisje që injekton ajër të kompresuar ose gaz në zgavrën e kafkës, ose një procesi të pastrimit të palcës, ose ndonjë procedure tjetër që mund të kontaminojë gjakun me ind nervor, para therjes; dhe

- janë prodhuar dhe trajtuar në një mënyrë që siguron që produkte të tilla nuk përmbajnë dhe nuk janë të kontaminuara me mallrat e listuara në pikën 1, të nenit 11.4.15, të Kodit Tokësor të WOAH ose mish i ndarë mekanikisht nga kafka, ose nga kolona vertebrale e gjedhit mbi 30 muajsh;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që:

i. kafshët e llojit gjedh nga të cilët është nxjerrë mielli proteinik janë identifikuar nëpërmjet një sistemi identifikimi të kafshëve dhe kanë lindur dhe janë mbajtur në një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE); dhe/ose

ii. kanë lindur pas datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhëve është treguar i papërfillshëm; ose

iii. mielli proteinik është përpunuar në përputhje me nenin 11.4.19 të Kodit Tokësor të WOAH përkatësisht:

- lënda e parë duhet të reduktohet në një madhësi maksimale grimcash prej 50 mm përpara ngrohjes dhe duhet të ngrohet në kushte avulli të ngopur në një temperaturë jo më të ulët se 133°C për një kohë minimale prej 20 minutash, në një presion absolut prej 3 bar; ose

- një procedurë alternative që është provuar se arrin të paktën një nivel të barasvlershëm reduktimi të infektivitetit të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE);

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që gjaku dhe produktet e gjakut, janë:

i. nxjerrë nga gjedhë që janë identifikuar përmes një sistemi identifikimi të kafshëve dhe kanë lindur dhe janë mbajtur në një vend, zonë ose ndarje që

paraqet një rrezik të papërfillshëm ose në një vend, zonë, ose ndarje që paraqet një rrezik të kontrolluar të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) pas datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhit është treguar i papërfillshëm; ose

ii. mbledhur nga gjedhë që nuk i janë nënshtruar një procesi trullosjeje me një pajisje që injekton ajër të kompresuar ose gaz në zgavrën e kafkës, ose një procesi të pastrimit të palcës, ose ndonjë procedure tjetër që mund të kontaminojë gjakun me ind nervor, para therjes; dhe

iii. mbledhur dhe përpunuar në një mënyrë që siguron që ato të mos kontaminohen me ind nervor;

d) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që dhjami i shkrirë:

i. vjen nga një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE); ose

ii. rrjedh nga kafshë të llojit gjedhë që i janë nënshtruar një inspektimi *ante mortem* me rezultate të favorshme dhe nuk është përgatitur, duke përdorur mallrat e listuara në pikën 1, të nenit 11.4.15 të Kodit Tokësor të WOAH;

dh) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që derivatet e dhjamit:

i. e kanë origjinën nga një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE); ose

ii. nxirren nga dhjami që plotëson kushtet e përmendura në nenin 11.4.16 të Kodit Tokësor të WOAH; ose

iii. janë prodhuar nga hidroliza, saponifikimi ose transesterifikimi që përdor temperaturë dhe presion të lartë;

e) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që dikalcium fosfati:

i. vjen nga një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE); ose

ii. është një bashkëprodukt i xhelatinës së kockave.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të kafshëve të gjalla të llojit gjedh, mishit të freskët dhe produkteve të mishit, miellit proteinik me origjinë nga kafshët e llojit gjedh ose çdo produkt që përmban një material të tillë, gjaku dhe produktet e gjakut të marra nga kafshët e llojit gjedh, dhjamit të shkrirë dhe derivatet e dhjamit, dikalcium fosfatit, ileumi distal nga gjedhët e çdo moshe, si dhe kafka, truri, sytë, shtylla kurrizore dhe palca kurrizore nga gjedhët që në momentin e therjes kanë qenë mbi 30 muajsh, ose çdo produkt i kontaminuar prej tyre, ushqim, ushqim për kafshë, plehra, produkte kozmetike, farmaceutike (përfshirë biologjike), pajisje mjekësore ose çdo produkt tjetër që përmban proteina të përgatitura që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të çdo ngarkese të kafshëve të gjalla të llojit gjedh, mishit të freskët dhe produkteve të mishit, miellit proteinik me origjinë nga kafshët e llojit gjedh ose çdo produkt që përmban një material të tillë, gjaku dhe produktet e gjakut të marra nga kafshët e llojit gjedh, dhjamit të shkrirë dhe derivatet e dhjamit, dikalcium fosfatit, ileumi distal nga gjedhët e çdo moshe, si dhe kafka, truri, sytë, shtylla kurrizore dhe palca kurrizore nga gjedhët që në momentin e therjes kanë qenë mbi 30 muajsh, ose çdo produkt i kontaminuar prej tyre, ushqim, ushqim për kafshë, plehra, produkte kozmetike, farmaceutike (përfshirë biologjike), pajisje mjekësore ose çdo produkt tjetër që përmban proteina të përgatitura, për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

VENDIM
Nr. 23, datë 4.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 4.3.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 20 (A) 2025, që u përket:

KËRKUES: Arjan Shtëmbari, Silvana Shtëmbari

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria "Shërbimi Përmbarimor Zig" sh.p.k., në mungesë.

Banka "Union Bank", në mungesë.

Manjola Anxhaku, Klodiana Anxhaku, Elton Kryekurti, përfaqësuar nga avokati Envi Hicka, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 2067, datë 6.10.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-4493, datë 13.11.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71/1, 71/a dhe 71/b, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve, Arjan Shtëmbari dhe Silvana Shtëmbari (*kërkuesit*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Manjola Anxhaku, Klodiana Anxhaku dhe Elton Kryekurti, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të tjera të interesuara, shoqërisë "Shërbimi Përmbarimor Zig" sh.p.k. (*shoqëria përmbarimore*) dhe bankës "Union Bank" (ish-Banka Ndërkombëtare Tregtare (*BNT*)), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Arjan Shtëmbari (*kërkuesi i parë*) në datën 31.5.2006, ka lidhur me BNT-në, aktualisht e përthithur nga banka "Union Bank", një kontratë kredie bankare, përmes së cilës i është dhënë hua shuma 2.500.000 lekë, me interes dhe me afat 36-mujor, duke u përcaktuar në kontratë edhe modalitetet e pagimit të principalit dhe interesave. Për garantimin e përmbushjes së këtij detyrimi, po në të njëjtën datë, palët kanë lidhur kontratën e hipotekës, me të cilën kërkuesi i parë ka vendosur në hipotekë, në favor të bankës, pasurinë e paluajtshme në pronësi të tij, të llojit "arë", me sipërfaqe 300 m^2, të ndodhur në Yzberisht, Tiranë. Kontrata e hipotekës është nënshkruar edhe nga bashkëshortja e tij, kërkuesja Silvana Shtëmbari (*kërkuesja e dytë*), në cilësinë e dorëzanëses.

2. Për shkak të mospërmbushjes së detyrimit për pagimin e kredisë bankare, me kërkesë të kreditorit BNT, me vendimin e datës 18.4.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për titullin ekzekutiv, kontratën e kredisë bankare. Në vijim, kreditori ka vënë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm dhe shoqëria përmbarimore ka realizuar këtë procedurë, gjatë së cilës ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme të vënë në hipotekë dhe, në vijim, ka proceduar me shitjen e saj në ankandin e datës 11.6.2012, ku fitues janë shpallur subjektet e interesuara Elton Kryekurti dhe Klodiana Anxhaku, të cilave në datën 19.6.2012 u ka kaluar pronësia për atë pasuri. Më pas, me vendimin e datës 9.7.2012, përmbaruesi gjyqësor ka vendosur pushimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Ndërkohë, me kontratën e shitjes së datës 12.7.2012, këta të fundit ia kanë shitur pronën subjektit tjetër të interesuar, Manjola Anxhaku.

3. Kërkuesi i parë, ndërsa procedura e ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv ende

nuk kishte përfunduar, ka përdorur paralelisht dy mjete juridike për t'u mbrojtur nga ekzekutimi, atë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv sipas nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)* dhe atë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore sipas nenit 610 të këtij kodi.

i. Procesi i parë gjyqësor

4. Në datën 16.5.2012, kërkuesi i parë i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, të kontratës së kredisë bankare, me pretendimin se detyrimi ekzistonte në një masë më të vogël. Po ashtu, ai ka kundërshtuar edhe veprimet përmbarimore, specifikisht vendimin për sekuestrimin e sendit, vendimin për caktimin e ekspertit dhe vendimin për përcaktimin e vlerës së tij. Në këtë rast, ai ka kërkuar edhe pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes.

5. Me vendimin nr. 12028, datë 10.12.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe çështja është kthyer për rigjykim. Në përfundim të rigjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1861, datë 11.3.2015, ka vendosur sërish rrëzimin e padisë.

6. Mbi ankimin e kërkuesit të parë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 802, datë 12.4.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar padinë dhe deklaruar se detyrimi që buron nga titulli ekzekutiv, kontrata e kredisë bankare, për paditësin (kërkuesin e parë) kundrejt kreditorit BNT, sipas aktit të ekspertimit, është në një masë më të vogël, konkretisht 851.395 lekë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-3213, datë 17.9.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga subjekti i interesuar, BNT-ja.

ii. Procesi i dytë gjyqësor (objekt i ankimit kushtetues individual)

7. Në datën 26.6.2012, kërkuesi i parë i është drejtuar gjykatës me padi, me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarimore. Ndonëse në objekt nuk janë përcaktuar veprimet konkrete përmbarimore, në përmbajtjen e padisë kërkuesi ka kundërshtuar specifikisht vendimin për shpalljen e fituesit të ankandit dhe kalimin e pronësisë së sendit, me pretendimin se këto veprime përmbarimore janë në kundërshtim me ligjin, pasi janë kryer në një kohë kur ai, në datën 16.5.2012, kishte paraqitur padi për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, çka, sipas tij, bënte të domosdoshëm pezullimin e veprimeve përmbarimore.

8. Gjatë gjykimit të çështjes, në seancën gjyqësore të datës 4.3.2013, kërkuesi i parë ka ngritur pretendime edhe për disa veprime të tjera përmbarimore që lidheshin me fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, vendosjen e sekuestros, ftesën për caktimin me marrëveshje të vlerës së sendit, caktimin e ekspertit dhe të vlerës së sendit, shpalljen e ankandit të parë dhe zhvillimin e tij. Ai ka pretenduar se për disa prej këtyre veprimeve përmbarimore njoftimi nuk ishte kryer ose ishte i pavlefshëm. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, ai ka paraqitur edhe një akt ekspertimi grafik të nënshkrimeve, të kryer me kërkesën e tij të datës 13.2.2013, sipas të cilit janë ekzaminuar nënshkrimet në aktet e njoftimit të katër veprimeve përmbarimore. Nga ana e tyre, kreditori BNT dhe shoqëria përmbarimore kanë prapësuar se padia, përveçse nuk qëndronte në themel, ishte e parashkruar, pasi, sipas nenit 610 të KPC-së, çdo veprim përmbarimor duhet të kundërshtohej me ankim të veçantë brenda afatit 5-ditor nga marrja dijeni.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4777, datë 2.5.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj, me arsyetimin e vetëm se veprimet përmbarimore janë kryer në përputhje me ligjin procedural civil dhe i janë njoftuar paditësit (kërkuesit të parë), si dhe, për më tepër, padia ka mbetur pa objekt, pasi prona është tjetërsuar. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 497, datë 27.9.2013, dhe çështja është kthyer për rigjykim, për shkak se vendimit të ankimuar i mungonte plotësisht arsyetimi, gjë që e bënte atë të pavlefshëm.

10. Në rigjykimin e çështjes, pas kërkesës së kërkueses së dytë, ajo është thirrur si ndërhyrëse dytësore. Ndërkohë, përpara mbylljes së hetimit gjyqësor, në seancën e datës 23.4.2014, kërkuesi i parë ka kërkuar ndryshimin e objektit të padisë, duke kërkuar pavlefshmërinë e njoftimeve të shoqërisë përmbarimore si akte të falsifikuara, si dhe të katër veprimeve përmbarimore që rridhnin prej tyre, konkretisht të lajmërimit për ekzekutim vullnetar të datës 17.5.2011, urdhrit të sekuestros konservative, të datës 2.6.2011, vendimit për caktimin e ekspertit të datës 19.4.2012 dhe vendimit për caktimin e vlerës së sendit, të datës 8.5.2012. Po ashtu, ai ka kërkuar

edhe pavlefshmërinë e kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme të datës 12.7.2012, rivendosjen e palëve në gjendjen e mëparshme dhe regjistrimin e pasurisë (tokës "arë" me sipërfaqe 300 m^2) në emër të tij. Me vendimin e ndërmjetëm të po asaj date, gjykata e shkallës së parë ka pranuar kërkesën, me arsyetimin se paditësi ka të drejtën për të ndryshuar objektin e padisë pa ndryshuar shkakun e saj, ndërsa përmes kërkesës ai ka specifikuar veprimet përmbarimore të kundërshtuara.

11. Në përfundim të rigjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5361, datë 30.4.2014, ka vendosur pranimin e padisë, duke shpallur të pavlefshme njoftimet për pesë veprime përmbarimore dhe, si pasojë, edhe vetë ato veprime. Po ashtu, ajo ka anuluar procedurën përmbarimore në tërësi, nga fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm dhe deri në pushimin e tij, duke urdhëruar kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Gjithashtu, ka shpallur të pavlefshme kontratën e shitjes së datës 12.7.2012 dhe ka disponuar kthimin reciprok të shumave të marra, si dhe ka urdhëruar regjistrimin e pasurisë në pronësi të kërkuesit të parë, për shkak anulimit të procedurës përmbarimore.

12. Në vendimin e saj, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se e gjithë procedura përmbarimore, nga momenti i fillimit të ekzekutimit të detyrueshëm dhe deri në përfundimin e saj, është e pavlefshme, pasi është realizuar në shkelje të së drejtës së paditësit për proces të rregullt ligjor, për shkak të mosnjoftimit të veprimeve përmbarimore, me pasojë cenimin e së drejtës së ankimit ndaj tyre, duke bërë që veprimet përmbarimore të jenë absolutisht të pavlefshme. Për sa i përket procesverbalit të takimit të datës 10.5.2012, të zhvilluar mes përmbaruesit gjyqësor dhe kërkuesit të parë, sipas asaj gjykate, është komunikuar vetëm vendimi për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, i kryer një vit më parë, por jo veprimet e tjera përmbarimore. Sipas saj, shënimi në procesverbal se paditësi mori dijeni edhe për shkresat e tjera të komunikuara nga përmbaruesi gjyqësor deri në momentin aktual, nuk ezauron detyrimin e përmbaruesit për njoftimin e veprimeve përmbarimore në përputhje me nenin 524 të KPC-së, për sa kohë në procesverbal nuk tregohet veprimi përmbarimor që është kryer në këtë rast. Po ashtu, gjykata ka vlerësuar se caktimi i vlerës së sendit të sekuestruar nuk ka qenë i nevojshëm, se kjo vlerë ishte në kundërshtim me ligjin, pasi rezultonte më e ulët se vlera e mëparshme, dhe se shuma e kërkuar dhe e marrë nga banka në përfundim të procedurës nuk gjente mbështetje as në kontratën e huas, as në ligj.

13. Në lidhje me prapësimet e të padituve se paditësi nuk ka treguar në gjykim se cili veprim përmbarimor ishte i pavlefshëm dhe shkakun përse, si dhe se ai, në padinë e tij, nuk ka kundërshtuar asnjë veprim përmbarimor brenda afatit 5-ditor sipas nenit 610 të KPC-së, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se ato nuk qëndrojnë. Sipas saj, ajo çfarë ka kontestuar paditësi në këtë proces nuk ishte ndonjë veprim i veçantë përmbarimor, pasi ai e kishte ngritur çështjen në nivel kushtetues, në lidhje me cenimin e së drejtës për ankim dhe për akses në gjykatë, si pjesë thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Sipas gjykatës, paditësi ka kontestuar në vijimësi njoftimet e veprimeve përmbarimore, duke qenë ky shkaku ligjor i padisë. Verifikimi i mënyrës së kryerjes së një ose disa veprimeve përmbarimore nuk ka qenë objekt i këtij gjykimi, por edhe sikur të ishte, ai do të kishte një rëndësi shumë herë më të vogël se verifikimi që gjykata duhej dhe i ka bërë shkeljes të të drejtave kushtetuese të palëve në një proces përmbarimor, pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor.

14. Mbi ankimin e të padituve, subjekteve të interesuara, kreditorit BNT, blerësit në ankand Elton Kryekurti dhe shoqërisë përmbarimore, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2067, datë 6.10.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit të parë. Ajo ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë kishte zbatuar gabim ligjin procedural civil dhe nuk kishte respektuar siç duhej dispozitat procedurale që rregullojnë pushtetin e gjykatës në procesin civil, rolin e paanshëm të saj dhe parimin e kontradiktoritetit. Sipas gjykatës së apelit, në kundërshtimin e veprimeve përmbarimore pala duhet të përcaktojë konkretisht veprimin që kundërshton, shkakun e ankimit dhe të drejtën e cenuar, pasi procesi gjyqësor duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në këtë kuptim, sipas saj, mosnjoftimi për një veprim përmbarimor nuk sjell vetvetiu pavlefshmërinë e tij, për sa kohë e drejta e ankimit lind nga momenti kur pala merr dijeni për veprimin. Gjykata e apelit ka theksuar gjithashtu se rregullat e ekzekutimit të detyrueshëm synojnë realizimin e së drejtës së kreditorit, duke garantuar njëkohësisht edhe të drejtën e debitorit për të kundërshtuar në gjykatë veprimet që cenojnë të

drejtat e tij. Ky kundërshtim duhet të ushtrohet brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 610 i KPC-së, respektimi i të cilit përbën detyrim për subjektin që inicion gjykimin civil, njësoj si detyrimi për të përcaktuar konkretisht veprimin që kundërshtohet dhe shkakun e paligjshmërisë së tij.

15. Në lidhje me çështjen në shqyrtim, gjykata e apelit ka konstatuar se, nga momenti i paraqitjes së ankimit për kundërshtimin e veprimit përmbarimor dhe deri në përfundimin e rigjykimit të çështjes nga gjykata e shkallës së parë, debitori (kërkuesi i parë), i lejuar edhe nga gjykata, ka modifikuar objektin dhe shkakun ligjor të ankimit të tij krahasuar me atë fillestar të paraqitur në datën 26.6.2012. Sipas saj, paditësi, fillimisht, ka kundërshtuar vendimin e datës 19.6.2012, për shpalljen e fituesit të ankandit dhe kalimin e pronësisë së sendit, duke paraqitur si shkak inicimin prej tij të një gjykimi tjetër me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv. Ndërkohë, gjatë rigjykimit të çështjes, ai ka zgjeruar objektin e mosmarrëveshjes, duke shtuar edhe veprime të tjera përmbarimore dhe, njëkohësisht, ka ndryshuar edhe shkakun ligjor të padisë, duke e lidhur atë me pavlefshmërinë e njoftimeve të veprimeve përmbarimore. Gjykata e apelit e ka gjetur të drejtë pretendimin e ankuesve, duke vlerësuar se megjithëse debitorit i garantohet e drejta e ngritjes së padisë, kjo e drejtë duhet të ushtrohet brenda kufizimeve procedurale të përcaktuara nga ligji, të cilat shërbejnë njëkohësisht edhe si garanci për palët e tjera. Për këtë arsye, sipas saj, debitori duhej të kishte kundërshtuar që në fillim çdo veprim përmbarimor që pretendonte se i cenonte të drejtat, duke treguar edhe shkakun përkatës, gjë të cilën nuk e ka bërë. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka çmuar se të vetmet kundërshtime të debitorit, të cilat përmbushnin kërkesat e ligjit për shqyrtimin në themel, janë ato ndaj veprimeve përmbarimore për shitjen e sendit në ankand, shpalljen e fituesit dhe kalimin e pronësisë së sendit në favor të blerësit.

16. Për sa u përket këtyre veprimeve përmbarimore, gjykata e apelit i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e paditësit (kërkuesit të parë), duke theksuar se nisja e një procesi gjyqësor me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv nuk passjell vetvetiu pezullimin e veprimeve përmbarimore, përveç rasteve të parashikuara nga ligji, konkretisht kur pezullimi vendoset nga gjykata që shqyrton vlefshmërinë e titullit ekzekutiv (neni 609 i KPC-së) ose në kushtet e tjera të përcaktuara në nenin 615 të këtij kodi. Në rastin konkret, ekzekutimi nuk është pezulluar as me vendim gjykate, as për ndonjë shkak tjetër ligjor, ndaj vijimi i procedurës së ekzekutimit nga përmbaruesi gjyqësor nuk vjen ndesh me asnjë dispozitë ligjore konkrete dhe, për pasojë, nuk ka asnjë shkak të ligjshëm për anulimin e këtij veprimi përmbarimor. Veç kësaj, në analizë të veprimit përmbarimor të ankandit, gjykata e apelit ka vlerësuar se shpallja publike e ankandit mbart në vetvete detyrime të përmbaruesit gjyqësor, si institucion publik, kundrejt të tretëve që paraqiten si ofertues, ndaj, me fillimin e procedurës së shitjes së sendit në ankand, debitori nuk mund të ndalojë shitjen e tij dhe i vetmi shkak për të cilin mund të mos kryhet ankandi, është pushimi i ekzekutimit të detyrimit, në kushtet e nenit 616 të KPC-së, ndërsa mbrojtja e të drejtave të të tretëve që marrin pjesë në ankand rezulton edhe nga përcaktimi i shkronjës "c", të nenit 615 të këtij kodi. Në rastin konkret, duke qenë se debitori kishte dijeni për zhvillimin e ankandit, çka vërtetohet me procesverbalin e datës 29.5.2012, por nuk ka marrë pjesë në të, ai nuk mund të kundërshtojë më pas shpalljen e fituesit dhe kalimin e pronësisë në mungesë të një shkaku të ligjshëm dhe të cenimit konkret të së drejtës së tij. Për rrjedhojë, sipas gjykatës së apelit, padia duhej të ishte rrëzuar. Ajo ka çmuar gjithashtu se edhe disponimet e gjykatës së shkallës së parë për raportet mes të padituve janë marrë përtej objektit të padisë dhe, për këtë arsye, konsiderohen të pabazuara në ligj.

17. Për rekursin e kërkuesve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4493, datë 13.11.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas këtij kolegji, gjykatat më të ulëta kanë respektuar normat procedurale, shkelja e të cilave mund të çojë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit, sikundër edhe të gjitha parimet bazë të procesit të rregullt ligjor. Gjykata e apelit ka zbatuar drejt dispozitat e ligjit material, duke bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave të mosmarrëveshjes, si dhe duke u dhënë përgjigje ezauruese pretendimeve të ngritura nga palët. Po ashtu, vendimi i gjykatës së apelit nuk bie ndesh me praktikën e mëparshme të Gjykatës së Lartë. Kolegji Civil ka theksuar se pretendimet në rekurs që lidhen me vlerësimin e provave dalin jashtë juridiksionit

rishikues të Gjykatës së Lartë, pasi kjo gjykatë nuk mund të rihapë shqyrtimin e provave ose të bëjë rivlerësimin e tyre.

18. Në datën 8.4.2025, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Gjykatës së Lartë të dhëna në procesin e dytë gjyqësor. Kolegji i Gjykatës në datën 11.6.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 25.6.2025, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në përbërjen e trupit gjykues nuk mori pjesë një anëtar i Gjykatës për arsye objektive.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

19. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

19.1 E drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

19.1.1 Së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi kërkuesve u është bërë e pamundur mbrojtja e së drejtës së pronës në rrugë gjyqësore, për shkak se procedura përmbarimore është kryer pa dijeninë e tyre. Atyre nuk u janë njoftuar veprimet përmbarimore për të cilat kishin të drejtën e ankimit në gjykatë. Mungesa e dijenisë për këto akte është vërtetuar me aktet e ekspertimit grafik të nënshkrimeve, sipas të cilave nënshkrimet janë të falsifikuara dhe njoftimet nuk janë firmosur nga kërkuesit. Për më tepër, kërkueses së dytë, si garantuese e kredisë, nuk i është komunikuar asnjë akt procedural i përmbaruesit. Veprimet e përmbaruesit gjyqësor janë kryer në keqbesim dhe ai nuk ka njoftuar për procedurën e shitjes së pronës në ankand, si dhe nuk ka ndjekur procedurën ligjore për marrëveshjen me debitorin për caktimin e çmimit të pasurisë.

19.1.2 Standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, pasi gjykata e apelit, pavarësisht se i ka pasur në dosje aktet e ekspertimit grafik, nuk i përmend në arsyetimin e saj, qoftë edhe si fakte, duke i shmangur padrejtësisht ato për të arritur në një konkluzion të paracaktuar dhe të padrejtë. Gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë arsyetuar me hollësi se përse nuk kanë marrë parasysh shkeljet e pretenduara të ligjit material e procedural ose të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë për pavlefshmërinë e njoftimeve. Gjykata e Lartë, ndonëse i përmend pretendimet për aktet e falsifikuara, nuk ka argumentuar dhe sqaruar se përse nuk ka marrë parasysh aktet shkencore që kanë vërtetuar falsifikimin dhe as ka arsyetuar se përse nuk i merr parasysh pretendimet e ngritura në rekurs.

19.2. E drejta e pronës private, si pasojë e cenimit të aksesit në gjykatë dhe për shkak se vendimet gjyqësore janë alogjike dhe në kundërshtim me ligjin për sa i takon vlerës dhe metodës së përdorur në përllogaritjen e vlerës së pasurisë së shitur në ankand. Në vitin 2006, kur është marrë kredia, trualli është vlerësuar nga ekspertët në shumën 8.100.000 lekë, duke u përfshirë kjo vlerë në kontratën e kredisë, ndërsa në vitin 2010, nga vlerësuesi i pasurive të paluajtshme, referuar çmimit të referencës, që është i detyrueshëm për transaksionet ligjore, në bazë të VKM-së nr. 1620, datë 26.11.2008 *(VKM nr. 1620/2008*), është vlerësuar në shumën 6.215.000 lekë. Ndërkohë, sipas aktit të ekspertimit të kryer dhe miratuar nga përmbaruesi, në prill të vitit 2012 trualli është vlerësuar në shumën 2.600.000 lekë, pra sa gjysma e vlerës sipas çmimit zyrtar të referencës, ndërsa në ankand është shitur rreth 2.000.000 lekë. Ky vlerësim i miratuar nga përmbaruesi dhe i lënë në fuqi nga gjykatat, jo vetëm që është i paligjshëm, pasi nuk është bazuar në VKM-në nr. 1620/2008, por është edhe absurd dhe alogjik, për sa kohë çmimi i truallit në treg ka ardhur duke u rritur dhe jo duke u zvogëluar. Shitja e truallit në ankand për një vlerë tre herë më të ulët se ajo e gjashtë vjetëve më parë ka cenuar të drejtën e pronës, për më tepër kur këto veprime janë kryer në fshehtësi dhe me akte të falsifikuara. Edhe banka ka abuzuar me kredinë, pasi detyrimi ka qenë shumë herë më i vogël, duke përfituar padrejtësisht.

20. ***Subjektet e interesuara, Manjola Anxhaku, Klodiana Anxhaku dhe Elton Kryekurti,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar:

20.1 Pretendimi për *cenimin e së drejtës së pronës të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë* është i pabazuar, pasi çështja është shqyrtuar dy herë në shkallë të parë dhe dy herë në gjykatën e apelit, ku, në një prej atyre rasteve, kjo e fundit ka urdhëruar shqyrtimin në themel dhe me efektivitet të pretendimeve të padisë. Kërkuesit të drejtën e aksesit e kanë lidhur thjesht me fatin e kërkimeve të padisë, pra me mospranimin e tyre. Gjykata e apelit ka realizuar në mënyrë

efektive dhe gjithëpërfshirëse zgjidhjen e çështjes, duke u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të kërkuesve dhe prapësimeve të të padituve.

20.2 Pretendimi për *cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi vendimi i gjykatës së apelit jo vetëm që nuk ka asnjë mangësi logjike, por përmban edhe arsyet ligjore mbi të cilat është bazuar zgjidhja e çështjes për të dyja palët. Gjykata e apelit e ka përmbushur në mënyrë të plotë dhe të qartë detyrimin për arsyetimin e vendimit gjyqësor, ndërsa qëndrimi i saj nuk paraqet kundërthënie ose zbrazëti në arsyetim. Edhe Gjykata e Lartë, ndonëse me një arsyetim të kufizuar, ka parashtruar shkaqet e rekursit dhe i ka vlerësuar ato në përputhje me standardet e arsyetimit në dhomën e këshillimit.

21. ***Subjektet e interesuara, banka "Union Bank" dhe shoqëria përmbarimore,*** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

22. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhen me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", nenit 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të drejtpërdrejta dhe reale të pësuara, shterimin e mjeteve juridike efektive, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

23. Për sa i përket legjitimimit *ratione personae,* në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, Gjykata vëren se si kërkuesi i parë, në cilësinë e paditësit, ashtu edhe kërkuesja e dytë, në cilësinë e ndërhyrëses dytësore, kanë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, për të cilin kanë ngritur pretendime në drejtim të cenimit të të drejtave të tyre kushtetuese, ndaj provojnë interesin e drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, si në aspektin formal, ashtu edhe substancial.

24. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar, në formë dhe përmbajtje, mjetet e zakonshme të ankimit përpara paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

25. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit gjyqësor i dhënë në çështjen e tyre, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 13.11.2024, i cili është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 5.12.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 8.4.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

26. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, në referim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, kërkuesit kanë pretenduar se u janë cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e *së drejtës së aksesit* dhe *standardit të arsyetimit të vendimit*, si dhe *e drejta e pronës private,* e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Në thelb, ata kanë pretenduar se mosnjoftimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor i ka vënë në pamundësi për t'i kundërshtuar ato në gjykatë, duke sjellë, sipas tyre, cenimin e *së drejtës së aksesit,* por edhe të *së drejtës së pronës private,* për shkak të humbjes së pronësisë mbi pasurinë e hipotekuar dhe të mënyrës së vlerësimit të saj në procedurën përmbarimore. Ata kanë pretenduar gjithashtu se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme përse nuk kanë marrë parasysh shkeljet e pretenduara të ligjit material e procedural, si dhe shkaqet e parashtruara në rekurs, duke cenuar *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.*

27. Për sa më sipër, Gjykata, bazuar në natyrën dhe thelbin e pretendimeve të parashtruara nga kërkuesit, çmon se çështja duhet të analizohet në këndvështrim të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, të lidhur me të drejtën e pronës private, në kuptim të nenit 41 të saj, për sa kohë argumentet e kërkuesve lidhen, në thelb,

me mënyrën sesi gjykatat e zakonshme kanë vlerësuar kundërshtimet e tyre ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, të cilat kanë sjellë humbjen e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme të vendosur si garanci për kontratën e kredisë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private

28. Kërkuesit kanë pretenduar se veprimet e përmbaruesit gjyqësor janë kryer në keqbesim dhe se ata nuk janë njoftuar për procedurën e shitjes së pronës në ankand dhe se nuk është ndjekur procedura ligjore për marrëveshjen me debitorin për caktimin e çmimit të pasurisë. Sipas tyre, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë arsyetuar me hollësi përse nuk kanë marrë parasysh shkeljet e pretenduara të ligjit material e procedural, si edhe praktikën gjyqësore lidhur me pavlefshmërinë e njoftimeve, si dhe nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura prej tyre. Po ashtu, sipas kërkuesve, vendimet gjyqësore janë alogjike dhe në kundërshtim me ligjin për sa i takon vlerës dhe metodës së përdorur në përllogaritjen e vlerës së pasurisë të shitur në ankand dhe shitja e saj për një vlerë tre herë më të ulët se ajo që prona kishte gjashtë vjet më parë ka cenuar të drejtën e tyre të pronës private, për më tepër kur këto veprime janë kryer në fshehtësi dhe me akte të falsifikuara. Gjithashtu, sipas tyre, edhe banka ka abuzuar me kredinë, pasi detyrimi ka qenë shumë herë më i vogël, duke përfituar kështu padrejtësisht.

29. Subjektet e interesuara, Manjola Anxhaku, Klodiana Anxhaku dhe Elton Kryekurti, kanë prapësuar se qëndrimi i gjykatës së apelit ka realizuar në mënyrë efektive dhe gjithëpërfshirëse zgjidhjen e çështjes, duke u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve e prapësimeve të palëve. Vendimi i gjykatës së apelit, vijojnë subjektet e interesuara, jo vetëm që nuk ka asnjë mangësi logjike, por përmban edhe arsyet ligjore mbi të cilat është bazuar zgjidhja e çështjes për të dyja palët. Ajo gjykatë, sipas tyre, e ka përmbushur në mënyrë të plotë dhe të qartë detyrimin për arsyetimin e vendimit gjyqësor, ndërsa qëndrimi i saj nuk paraqet kundërthënie ose zbrazëti në arsyetim. Edhe Gjykata e Lartë, shprehen ato, ndonëse me një arsyetim të kufizuar, ka parashtruar shkaqet e rekursit dhe i ka vlerësuar ato në përputhje me standardet e arsyetimit në dhomën e këshillimit.

30. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë nga një gjykatë. Ndërsa neni 41 i Kushtetutës parashikon se e drejta e pronës private është e garantuar (pika 1) dhe se prona fitohet, ndër të tjera, me blerje (pika 2).

31. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit, si një nga aspektet e së drejtës për proces të rregullt, u garanton subjekteve që pretendojnë cenimin e një të drejte mundësinë t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë nuk kufizohet vetëm në fillimin formal të procesit, por përfshin edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal *(shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

32. Gjykata, po ashtu, ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë, ndërsa vlerësimi i mjaftueshmërisë së tij bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes (*shih vendimet nr. 12, datë 28.2.2024; nr. 12, datë 19.3.2015; nr. 33, datë 8.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka theksuar se arsyetimi i kufizuar i tyre nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 21, datë 16.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Gjykata, gjithashtu, ka theksuar se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor dhe se marrja e vendimit për çështje kushtetuese kushtëzohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor *(shih vendimin nr. 39, datë 5.5.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Vlerësimi i fakteve dhe provave, si dhe interpretimi i ligjit për

zgjidhjen e mosmarrëveshjes u takojnë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndërsa detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme dhe të thelbit të pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjykata do të vlerësojë nëse gjykata e apelit, në interpretim dhe zbatim të rregullave procedurale për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë të kërkuesit të parë dhe nëse ka arsyetuar mjaftueshëm për rrëzimin e padisë së tij, si dhe, në vijim, nëse Gjykata e Lartë ka respektuar detyrimin e saj për t'u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekursin e kërkuesve.

35. Nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata vëren se mosmarrëveshja përpara gjykatave të zakonshme ka të bëjë me ekzekutimin e titullit ekzekutiv, kontratës së kredisë të lidhur në vitin 2006 nga kërkuesi i parë me BNT-në për shumën 2.500.000 lekë, me afat 36 muaj, për garantimin e së cilës është lidhur edhe kontrata e hipotekës për pasurinë e paluajtshme të llojit "arë", me sipërfaqe 300 m^2, të ndodhur në Yzberisht, Tiranë. Pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit me vendimin gjyqësor të datës 18.4.2011, përmbaruesi gjyqësor, përgjatë gati 14 muajve, ka kryer një sërë veprimesh përmbarimore, ndër të cilat, njoftimin e datës 17.5.2011, për ekzekutimin vullnetar, fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm në datën 2.6.2011, sekuestrimin e sendit të vënë në hipotekë në datën 7.6.2011, ftesën e datës 5.7.2011, për caktimin e vlerës së sendit me marrëveshje, caktimin e ekspertit në datën 19.4.2012 dhe të vlerës së sendit në datën 8.5.2012, shpalljen e ankandit të parë në datën 25.5.2012 dhe zhvillimin e tij në datën 11.6.2012, shpalljen e fituesit të ankandit në datën 19.6.2012 dhe kalimin atij në pronësi të sendit dhe, në përfundim, pushimin e ekzekutimit në datën 9.7.2012. Pas ankandit blerësit Elton Kryekurti dhe Klodiana Anxhaku ia kanë shitur pasurinë Manjola Anxhakut.

36. Gjithashtu, nga aktet rezulton se në dosjen përmbarimore janë administruar dhe aktet përkatëse të njoftimit për veprimet e kryera. Po ashtu, është administruar edhe procesverbali i datës 10.5.2012, në të cilin është dokumentuar një takim midis përmbaruesit gjyqësor dhe debitorit (kërkuesit të parë), ku ky i fundit ka deklaruar se ka marrë dijeni për shkresën për ekzekutimin vullnetar dhe për shkresat e tjera të komunikuara nga përmbaruesi gjyqësor deri në atë moment. Në dosje është edhe procesverbali i datës 29.5.2012, ku është dokumentuar një takim tjetër mes tyre, në të cilin debitori ka deklaruar se ka marrë dijeni për shkresat e komunikuara nga përmbaruesi gjyqësor, ndër të tjera, edhe për shpalljen e ankandit të parë, si dhe njoftimin për zhvillimin e tij në datën 11.6.2012.

37. Në datën 16.5.2012, kërkuesi i parë ka paraqitur padi për kundërshtimin e titullit ekzekutiv, me pretendimin se detyrimi është në një vlerë më të vogël, ndërsa në datën 26.6.2012, ka paraqitur edhe padinë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, në përmbajtje të së cilës ka kundërshtuar specifikisht vendimin për shpalljen e fituesit të ankandit dhe kalimin e pronësisë së sendit *(shih paragrafët 4 dhe 7 të vendimit)*. Gjatë shqyrtimit të padisë së dytë, në seancën e datës 4.3.2013, ndonëse nuk ka kërkuar shtimin e objektit të padisë, ai ka parashtruar pretendime edhe ndaj disa veprimeve të tjera përmbarimore, kur për katër prej tyre ka pretenduar mungesën e njoftimit, duke paraqitur për këtë edhe një akt ekspertimi grafik nënshkrimi, të kryer me kërkesën e tij të datës 13.2.2013 *(shih paragrafin 8 të vendimit)*. Vlen të theksohet se shoqëria përmbarimore për qëllime të procesit gjyqësor e ka depozituar dosjen përmbarimore në datën 15.4.2013. Ndërkohë, kreditori BNT dhe shoqëria përmbarimore kanë prapësuar se padia, përveçse nuk qëndronte në themel, ishte parashkruar sipas nenit 610 të KPC-së, pasi çdo veprim përmbarimor duhet të jetë objekt i një ankimi të veçantë, që duhet të paraqitet brenda afatit 5-ditor nga momenti i marrjes dijeni *(shih paragrafin 8 të vendimit)*. Gjykata e shkallës së parë, me vendimin e datës 2.5.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit të parë, me arsyetimin se veprimet përmbarimore janë kryer në përputhje me ligjin procedural civil dhe i janë njoftuar paditësit. Për shkak të mungesës së plotë të

arsyetimit, ky vendim është prishur nga gjykata e apelit me vendimin e datës 27.9.2013 *(shih paragrafin 9 të vendimit)*.

38. Në rigjykimin e çështjes, në seancën e datës 23.4.2014, kërkuesi i parë ka kërkuar ndryshimin e objektit të padisë, duke kërkuar pavlefshmërinë e njoftimeve dhe të katër veprimeve përmbarimore, konkretisht të lajmërimit për ekzekutim vullnetar të datës 17.5.2011, urdhrit për vënien e sekuestros konservative të datës 2.6.2011, vendimit për caktimin e ekspertit për vlerësimin e sendit të paluajtshëm të datës 19.4.2012 dhe vendimit për caktimin e vlerës së sendit të paluajtshëm të datës 8.5.2012. Po ashtu, duke e konsideruar si rregullim të pasojave të pavlefshmërisë së pretenduar të veprimeve përmbarimore, krahas pavlefshmërisë së kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme të lidhur mes të padituve, ai ka kërkuar edhe kthimin reciprok të shumave të marra, si dhe regjistrimin e pasurisë (tokës "arë" me sipërfaqe 300 m^2) në emër të tij *(shih paragrafin 10 të vendimit)*.

39. Gjykata e shkallës së parë, me vendimin e datës 30.4.2014, ka vendosur pranimin e padisë së kërkuesit të parë. Ajo ka shpallur të pavlefshme njoftimet për katër veprimet përmbarimore dhe, për këtë shkak, edhe vetë veprimet përmbarimore. Për të njëjtin shkak, ajo ka anuluar në tërësi procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm, pra të gjitha veprimet përmbarimore, duke urdhëruar edhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Po ashtu, ajo ka shpallur të pavlefshme kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme të lidhur mes të padituve, duke urdhëruar edhe kthimin reciprok të shumave të marra, si dhe regjistrimin e pasurisë (tokës "arë" me sipërfaqe 300 m^2) në pronësi të kërkuesit të parë *(shih paragrafët 11 dhe 12 të vendimit)*. Ndërkohë, gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar prapësimet e të padituve se paditësi (kërkuesi i parë) nuk ka treguar në gjykim se cili veprim përmbarimor ishte i pavlefshëm dhe për çfarë shkaku, si dhe se ai nuk ka kundërshtuar asnjë veprim përmbarimor brenda afatit 5-ditor sipas nenit 610 të KPC-së. Sipas saj, paditësi nuk kishte kontestuar ndonjë veprim të veçantë përmbarimor, por çështjen ai e kishte lidhur me cenimin e së drejtës për ankim dhe për akses në gjykatë, si pjesë thelbësore të procesit të rregullt ligjor, ndërsa në vijimësi ka kontestuar njoftimin e veprimeve përmbarimore, duke mos qenë kështu objekt gjykimi mënyra e kryerjes së një ose disa veprimeve përmbarimore *(shih paragrafin 13 të vendimit)*.

40. Gjykata e apelit, me vendimin e datës 6.10.2015, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka rrëzuar padinë e kërkuesit të parë. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabim ligjin procedural civil, pasi, në kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, pala duhet të përcaktojë konkretisht veprimin që kundërshton, shkakun e ankimit dhe të drejtën e cenuar. Po sipas gjykatës së apelit, mosnjoftimi i një veprimi përmbarimor nuk sjell vetvetiu pavlefshmërinë e tij, për sa kohë e drejta e ankimit lind nga momenti kur pala merr dijeni për veprimin, ndërsa ky kundërshtim duhet të ushtrohet brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 610 i KPC-së *(shih paragrafin 14 të vendimit)*. Mbi këtë bazë, gjykata e apelit ka vlerësuar se kërkuesi i parë, gjatë rigjykimit, ka zgjeruar objektin e mosmarrëveshjes duke shtuar edhe veprime të tjera përmbarimore dhe, njëkohësisht, ka ndryshuar edhe shkakun ligjor të padisë, krahasuar me ankimin fillestar të datës 26.6.2012. Sipas saj, ai duhej të kishte kundërshtuar që në fillim çdo veprim përmbarimor që pretendonte se i cenonte të drejtat, duke treguar edhe shkakun përkatës. Për rrjedhojë, ajo ka çmuar se të vetmet kundërshtime që përmbushnin kërkesat ligjore për shqyrtim në themel janë ato ndaj veprimeve përmbarimore për shitjen e sendit në ankand, shpalljen e fituesit dhe kalimin e pronësisë së sendit në favor të blerësit *(shih paragrafin 15 të vendimit)*.

41. Në vijim, për këto veprime përmbarimore, gjykata e apelit i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e kërkuesit të parë. Ajo ka theksuar se nisja e një procesi gjyqësor me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv nuk sjell vetvetiu pezullimin e veprimeve përmbarimore, përveç rasteve të parashikuara nga nenet 609 dhe 615 të KPC-së, dhe se, në rastin konkret, ekzekutimi nuk ishte pezulluar me vendim gjykate ose për ndonjë shkak tjetër ligjor. Gjithashtu, ajo ka vlerësuar se kërkuesi i parë ka pasur dijeni për zhvillimin e ankandit, por nuk ka marrë pjesë në të, ndaj nuk mund të kundërshtonte më pas shpalljen e fituesit dhe kalimin e pronësisë në mungesë të një shkaku të ligjshëm dhe të cenimit konkret të së drejtës së tij. Po ashtu, gjykata e apelit ka çmuar se disponimet e gjykatës së shkallës së parë për raportet mes të padituve janë marrë përtej objektit të padisë dhe,

për këtë arsye, konsiderohen të pabazuara në ligj *(shih paragrafin 16 të vendimit)*.

42. Për rekursin e kërkuesve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 13.11.2024, në dhomën e këshillimit, në fazën e shqyrtimit paraprak, ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 472 i KPC-së. Sipas atij kolegji, gjykata e apelit ka zbatuar drejt ligjin, duke bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave të mosmarrëveshjes, si dhe u ka dhënë përgjigje ezauruese pretendimeve të ngritura nga palët, ndërsa pretendimet në rekurs që lidhen me vlerësimin e provave dalin jashtë juridiksionit rishikues të Gjykatës së Lartë *(shih paragrafin 17 të vendimit)*.

43. Gjykata ka pranuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por shërben për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Mospërcaktimi i tyre do të çonte në një situatë ku konfliktet gjyqësore nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të mbetej e pasigurt, pasi në çdo moment një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht, do të mund të cenohej ose prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë *(shih vendimet nr. 27, datë 18.5.2023; nr. 29, datë 15.5.2014; nr. 5, datë 2.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në rastin kur kushtet e paraqitjes së ankimit ose padisë, siç është afati, janë përcaktuar nga ligji, Gjykata ka vënë në dukje rëndësinë kushtetuese që ka zbatimi dhe interpretimi i dispozitave ligjore nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë Gjykatën e Lartë, me qëllim që individit t'i garantohet procesi i rregullt në aspektet e aksesit në gjykatë dhe të mbrojtjes efektive *(shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 40, datë 22.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*. Respektimi i afatit ligjor lidhet me parimin e sigurisë juridike, i cili, mes të tjerash, nënkupton besueshmërinë e individit te shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 62, datë 31.7.2017; nr. 2, datë 29.1.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) çështjen e proporcionalitetit të ndërhyrjes në të drejtën e aksesit e ka trajtuar edhe në këndvështrim të gabimeve procedurale që ndodhin gjatë procedurave dhe që e pengojnë aplikantin të ketë akses në gjykatë, duke vlerësuar nëse, për këtë shkak, atij i është ngarkuar një barrë e tepruar. Kur gabimi procedural ka ndodhur vetëm nga njëra palë, qoftë aplikanti, qoftë autoritetet, veçanërisht gjykatat, GJEDNJ-ja është prirur t'ia ngarkojë pasojat atij që e ka shkaktuar gabimin. Sipas saj, kufizimi i aksesit në gjykatë do të ishte joproporcional kur papranueshmëria e një mjeti juridik është rezultat i atribuimit aplikantit të një gabimi për të cilin ai nuk është objektivisht përgjegjës. Po sipas GJEDNJ-së, vendosja dhe respektimi i rregullave procedurale formale, nëpërmjet të cilave palët sigurojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje civile, ka një rëndësi të veçantë, pasi kufizon diskrecionin, siguron barazinë e armëve, shmang arbitraritetin, siguron zgjidhjen efektive të çështjes dhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, si dhe garanton sigurinë juridike dhe respektin për gjykatën (*shih Zubac kundër Kroacisë (Dh.M.), nr. 40160/12, datë 5.4.2018, §§§ 90, 95, 96*).

45. Gjykata vëren se sipas nenit 610 të KPC-së, kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ky kod, palët mund të bëjnë ankim brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit kur palët kanë qenë të pranishme dhe, në raste të tjera nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni për veprimin ose refuzimin. Në rastin konkret, kërkuesi, brenda afatit ligjor, në datën 26.6.2012, ka kundërshtuar veprimet përmbarimore për shitjen e sendit në ankand, shpalljen e fituesit dhe kalimin e pronësisë së sendit në favor të blerësit. Nga ana tjetër, përtej pretendimeve të kërkuesve në lidhje me mungesën e njoftimit të rregullt për katër nga veprimet përmbarimore, është fakt se, së paku nga data 13.2.2013, kur kanë kërkuar në mënyrë private kryerjen e ekspertimit grafik të nënshkrimit, dhe në çdo rast jo më vonë se data 4.3.2013, kur në parashtrimet e tij kërkuesi i parë ka evidentuar të gjitha veprimet përmbarimore të kryera, ai ka pasur dijeni efektive jo vetëm për ekzistencën e tyre, por edhe për aktet përkatëse ku ishin dokumentuar, të cilat, gjithsesi, për qëllime të procesit gjyqësor, janë depozituar në gjykim në datën 15.4.2013. Megjithatë, ai ka kundërshtuar katër nga veprimet përmbarimore vetëm në datën 23.4.2014, në rigjykimin e çështjes, kur ka zgjeruar objektin e mosmarrëveshjes.

46. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se përfundimi i gjykatës së apelit, sipas të cilit të vetmet kundërshtime të debitorit (kërkuesit të parë) që

përmbushnin kërkesat e ligjit për shqyrtimin në themel, ishin ato ndaj veprimeve përmbarimore për shitjen e sendit në ankand, shpalljen e fituesit dhe kalimin e pronësisë së sendit në favor të blerësit, ndërsa kundërshtimet e tjera nuk ishin ushtruar brenda kufizimeve procedurale të përcaktuara nga ligji, nuk është i paarsyeshëm ose arbitrar. Ankimi i kërkuesit të parë për kundërshtimin e veprimeve të fundit përmbarimore nuk i rivendoste atij afatin për kundërshtimin e të gjithë procedurës përmbarimore, pra edhe të veprimeve që i kanë paraprirë ankandit dhe kalimit të pronësisë së sendit. Ndonëse kërkuesit kanë pasur mundësi të përdornin mjetet juridike për mbrojtjen nga ekzekutimi, të cilat janë të qarta dhe të parashikueshme në drejtim të pasojave të tyre, ata nuk e kanë bërë këtë dhe as nuk kanë provuar që mosparaqitja në afat e padisë për kundërshtimin edhe të veprimeve të mëparshme përmbarimore ka ardhur si pasojë e ndonjë gabimi të palës tjetër ose të vet gjykatës, gabim i cili nuk mund t'u ngarkohej atyre (kërkuesve).

47. Në vlerësimin e Gjykatës, mosrespektimi nga kërkuesi i parë i afateve ligjore për kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, duke parashtruar edhe veprimin konkret që kundërshtohej, si dhe shkakun e paligjshmërisë, ka sjellë si pasojë humbjen e së drejtës së ankimit edhe për kundërshtimin e vlerës së sendit. Kërkuesve u është garantuar e drejta për të ngritur padi, por ajo duhej të ushtrohej brenda afatit që parashikon ligji procedural civil, afat i cili, në kuptim të parimit të sigurisë juridike, përbën garanci procedurale edhe për pjesëmarrësit e tjerë në këtë procedurë, si për vijimin e ekzekutimit, ashtu edhe për ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes të të drejtave të tyre. Për rrjedhojë, për sa kohë që për veprimet e tjera përmbarimore që i kanë paraprirë ankandit kërkuesi i parë ka humbur afatin ligjor për kundërshtimin e secilit prej tyre, ankimi i tij kundër veprimeve të fundit përmbarimore nuk iu rivendos kërkuesve të drejtën edhe për të kundërshtuar edhe veprimet e tjera përmbarimore. Në këto kushte, kundërshtimi i këtyre veprimeve përmbarimore gjatë procesit gjyqësor nuk mund të krijonte ndonjë pritshmëri të arsyeshme për rivendosjen në afat për ushtrimin e së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të ankimit kundër të gjithë procedurës përmbarimore, për sa kohë që vetë kërkuesi i parë nuk ka treguar kujdesin e duhur për ushtrimin e këtyre të drejtave në përputhje me afatet ligjore.

48. Gjykata e apelit e ka gjetur të pabazuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë për vlerësimin e të gjitha veprimeve të kundërshtuara nga kërkuesit, ndërsa, në analizë të veprimeve përmbarimore për shitjen e sendit në ankand, shpalljen e fituesit dhe kalimin e pronësisë së sendit në favor të blerësit, si të vetmet veprime përmbarimore për të cilat kërkuesi i parë ka qenë në afat, i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e ngritura prej tij. Në këto kushte, gjykata e apelit, në interpretim dhe zbatim të dispozitave ligjore të zbatueshme dhe në përputhje me funksionin e saj, i ka dhënë përgjigje të arsyetuar kërkuesve si për kufijtë proceduralë të shqyrtimit, ashtu edhe për pretendimet që mund të shqyrtoheshin në themel. Për rrjedhojë, gjykata e apelit dhe, në vijim, edhe Gjykata e Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, kanë zbatuar dispozitat procedurale duke korrigjuar zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykata e shkallës së parë, e cila kishte lejuar zgjerim të objektit të mosmarrëveshjes përtej kufijve proceduralë të parashikuar nga ligji, duke garantuar kështu parimin e sigurisë juridike dhe të efektivitetit në administrimin e drejtësisë.

49. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkuesit kanë marrë një përgjigje përfundimtare dhe të arsyetuar për pretendimet e tyre, duke iu garantuar kështu e drejta e aksesit në gjykatë e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Arsyetimi i vendimeve objekt i ankimit kushtetues individual, në interpretimin dhe zbatimin e ligjit procedural në çështjen konkrete, nuk duket arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm, në kuptimin që të bjerë ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë.

50. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të lidhura me të drejtën e pronës private, është i pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 4.3.2026.

Shpallur më 27.4.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini

VENDIM
Nr. 14, datë 29.4.2026

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.3.2026, "Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve", në zbatim të nenit 21/3 dhe të nenit 21/5 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, "Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, 'Për akcizat në Republikën e Shqipërisë"', të ndryshuar;

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018 dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.

2. Vlera "Premio" zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të një dite më parë.

3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare "S&P Global Platts" në USD, në kushtet e livrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit (përfshijnë edhe TVSH-në), janë çmime tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.

4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar, janë si më poshtë:

a) Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:

- 191 lekë/litri për gazoilin;
- 168 lekë/litri për benzinën.

b) Çmimet tavan (max), për shitjen me pakicë të produkteve:

- 203 lekë/litri për gazoilin;
- 180 lekë/litri për benzinën.

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, "Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, 'Për akcizat në Republikën e Shqipërisë"', të ndryshuar, ku është parashikuar, se në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoili është më i lartë se 220 lekë/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lekë/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.

6. Ngarkohet administrata doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944 me 39.376230 lekë/litri, dhe për produktin benzinë, sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249 me 39.376230 lekë/litri.

7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë, është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga bordi.

8. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datë 29.4.2026, ora 11:30, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.

9. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Enea Karakaci, Arjana Dyrmishi, Ilir Binaj, Besmir Beja, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu, Sezar Beqaj, Nimet Veliaj, Dritan Basha, Arlind Fida, Klaudio Gega

VENDIM
Nr. 15, datë 30.4.2026

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.3.2026, "Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve", në zbatim të nenit 21/3 dhe nenit 21/5 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, "Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, 'Për akcizat në Republikën e Shqipërisë'", të ndryshuar;

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018 dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.

2. Vlera "Premio" zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të një dite më parë.

3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare "S&P Global Platts" në USD, në kushtet e livrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit (përfshijnë edhe TVSH-në), janë çmime tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar.

4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar, janë si më poshtë:

a) Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:

- 196 lekë/litri për gazoilin;
- 173 lekë/litri për benzinën.

b) Çmimet tavan (max), për shitjen me pakicë të produkteve:

- 208 lekë/litri për gazoilin;
- 185 lekë/litri për benzinën.

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, "Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, 'Për akcizat në Republikën e Shqipërisë'", të ndryshuar, ku është parashikuar, se në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoili është më i lartë se 220 lekë/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lekë/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë, sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.

6. Ngarkohet administrata doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944, me 39.376230 lekë/litri, dhe për produktin benzinë, sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249, me 39.376230 lekë/litri.

7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga Bordi.

8. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 30.4.2026, ora 13:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.

9. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Sezar Beqaj, Enea Karakaci, Nimet Veliaj, Arjana Dyrmishi, Dritan Basha, Ilir Binaj, Arlind Fida, Besmir Beja, Klaudio Gega, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu

KËRKESË

Shtetasi Bilal Ramaliu kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë shpalljen të vdekur të shtetasit Elmaz Ramaliu, i datëlindjes 1.9.1940, me atësi Liman dhe me amësi Hanke.

KËRKUES
Bilal Ramaliu

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2026/05/04 12:17:02 +02'00'
5710a30fe23c4987ac738f4b1a6c15eb2

Çmimi 96 lekë

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)